



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

KOMUNA KLINË  
DREJTORIA E ARSIMIT  
04 Nr. 111-2129/ 2016  
Klinë, më 25.04.2016

Mbështetur në nenin 8, pika 1, të Ligjit të punës nr. 03/L-212 si dhe në nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, si dhe në normativin mbi përzgjedhjen e kuadrit mësimor 06/2015, neni 7, pika 1, Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë në bashkëpunim me Save the Children publikon:

## K O N K U R S

### Institucioni parashkollor “ Xhevë Lladrovci ” Klinë

*-Një edukator/ e mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta të moshës 0-6 vjeç, që do të punojë me orar të plotë deri më 31 dhjetor 2017, me mundësi vazhdimi .*

#### Kualifikimet dhe shkathtësitë e nevojshme:

- Fakulteti i edukimit – programi parashkollor, fakulteti edukimit– programi i pedagogjisë,
- Përparësi kanë kandidatët që kanë përvojë të punës me fëmijë me nevoja të veçanta
- Vrojtton të gjithë fëmijët për të identifikuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore
- Mbështet nxënësit që kanë nevoja të veçanta arsimore dhe vështirësi në të nxënë ;
- Planifikon dhe organizon bashkë me edukatorët e tjera ;
- Kur ka nevojë për punë individuale me ndonjë fëmijë dhe vlerësohet se kjo është e domosdoshme, atëherë punon me të individualisht jashtë grupit
- Përpilon planin individual të arsimit bashkë me edukatorët e rregullt, prindin dhe anëtarët tjerë të ekipet të PIA
- Këshillon dhe ndihmon edukatorët e rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe si të menaxhoj me grupin gjithëpërfshirëse
- Harton materiale mësimore alternative bashkë me edukatorët e tjera
- Ndihmon drejtorin e shkollës dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore ;
- Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të mësimdhënies, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për fëmijët me

nevoja të veçanta arsimore varësisht nga nevojat specifike që paraqiten në qerdhe.

- Të ketë njohuri për zhvillimin dhe edukimin gjatë fëmijërisë së hershme, të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve.
- Shkathtësi që të punojë në mënyrë të përshtatshme, fleksibile dhe efektive në punë ekipore.
- Shkathtësi të punës me kompjuter.
- Të ketë kreativitet, iniciativë dhe të njoh mirë komunitetin ku vepron dhe nevojat e tyre.
- Trajnimet e vijara për zhvillimin dhe edukimin gjatë fëmijërisë së hershme dhe trajnimeve për punë me fëmijë me nevoja të veçanta janë përparësi.
- Raporton në baza të rregullta sipas formatit të caktuar të raportimit për Save the Children, që do të vihet në dispozicion edhe për DKA-n.
- Edukatori/ja parashkollor/e mbështetës/e do të punoj nën menaxhimin e Save the Children, në bashkëpunim me menaxherin e linjës sipas përcaktimit nga DKA.

#### UDHËZIM PËR APLIKIM

1. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në DKA bashkë me fotokopjet e dokumentit të kualifikimit dhe me fotokopjen e certifikatës së lindjes si dhe fotokopje të ndonjë dëshmie shtesë (licenca, trajnime, përvoja e punës në arsim etj. ) brenda orarit zyrtar të punës (prej orës 8-16 ).

Dokumentet e pakompletuara nuk do të pranohen si dhe **dokumentet e konkurrimit nuk kthehen.**

2. Afati i konkurrimit është 10 ditë nga data e publikimit.

3. Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatë që i plotësojnë kushtet në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2015 .

4. DKA-ja për orarin e intervistimit, kandidatët e listës së ngushtë do t'i njoftojë me telefon

